



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 4608, Datë 05.04. 2022

**Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhet**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.1250, datë 11.03.2022 “Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022”, Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës Këshillit të Bashkiak,

**Për të vendosur :**

1. Miratimin e një shtese në buxhetin e bashkisë për vitin 2022, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2022 në shumën 1,172,000 lekë, fond i cili është akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor si më poshtë:

- Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 për shumën 1,172,000 lekë lekë, fond i cili do të përdoret për paga në shumën 1,004,284 lekë dhe sigurime shoqërore në shumën 167,716 lekë.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të kontigjencës në shumën 1,274,500 lekë, fond i cili do të për mbulimin e shpenzimeve paparashikuara në buxhet, për këtë :

- Pakësohet : Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.609 për shumën 1,274,500 lekë.

- Shtohet : Gr.00, Prog.10430, Kap.01, Art.600 për shumën 1,092,116 lekë dhe Art.601 për shumën 182,384 lekë, Këto shpenzime do të bëhen për 5 punonjësit e projektit “Tungjateta Jetë”.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL**

Nr. 3666 Prot.

Lezhë, më: 24.03.2022

**MIRATOI**  
**KRYETARI**  
Pjerin Ndreu



**Lënda: Kërkesë për mbështetje financiare për financimin e pagesave të 5 punonjësve të projektit shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar.**

**DREJTORISË SË FINANCAVE DHE BUXHETIT**

Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, bazuar në nenin 24/4 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, në nenet 12, 13, 36, 47 të ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, shkresën nr.1250, datë 11.03.2022 transferim fondesh të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin në vitin e tretë të projekt-propozimit, kërkojmë miratimin e këtij fondi me vlerë 1.172.000 lekë (paga 1.004.284 lekë dhe sigurime shoqërore 167.716 lekë) që të përdoret për një pjesë të pagesave të stafit të shërbimit lëvizës .

Por, për të përballuar pagesën e plotë, për paga e sigurime shoqërore për 5 punonjësit e projektit, fond i cili shkon 2.446,500 lekë, (paga (600) – 2,096,400 lekë dhe sigurime shoqërore (601) 350,100 lekë),

Kërkoj nga ana juaj që të mbulohet diferenca e fondit për shumën 1,274,500 lekë për të mundësuar pagesën e 5 specialistëve të shërbimit lëvizës për periudhën 9 mujore për pamundësi mbulimit të këtyre shpenzimeve me fondet brenda programit 10430.

Bashkëlidhur kërkesës ju dërgoj shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale , relacionin përkatës, fish-projektin dhe formularin e kostos së shërbimit.

Faleminderit për bashkëpunimin,

**Drejtori i Shërbimit dhe Kujdesit Social**

**Marte Fetaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Lezhë, më: 24 /03/2022

## RELACION

**Projekti:** Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhë.

Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar në Bashkinë Lezhë është një projekt i fituar referuar shkresës nr.4993/3, datë 18.09.2019, në kuadër të thirrjes së parë për projekt propozime të programit të fondit social thirrje e hapur nga Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Ky është një program social që ofron shërbime të specializuara në shtëpi për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në zona të thella të vendit.

Ky program filloi të zbatohet për herë të parë në Bashkinë Lezhë në prill të vitit 2020. Pamundësia ekonomike, largësia nga qendrat, mungesa e transportit apo mentaliteti janë vetëm një pjesë e vogël mes një liste të gjatë faktorësh se përse fëmijët nuk merrnin dot shërbimet e specializuara për të cilat kishin nevojë.

Në këto rrethana Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar filloj shërbimin duke dërguar ekipe specialistësh për të vizituar fëmijët në banesat e tyre dhe për të ofruar terapi për ta sipas diagnozës së tyre. Fëmijët ndiqen hap pas hapi në bazë të planeve individuale të zhvillimit që hartohen për ta.

Shërbimi lëvizës sot ofron terapi për 40 fëmijë (29 djem dhe 11 vajza) me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në zona të thella të Lezhës. Njesia lëvizëse ofron shërbim një herë në javë në shtëpinë e çdo fëmijë i cili/ e cila përfiton mesatarisht një seancë në javë, ku çdo seancë zgjat 60 minuta, nga të cilat 45 minuta specialisti ia kushton fëmijës dhe 15 minuta aftësimit të prindit për të realizuar ushtrime të thjeshta në vijim të terapisë. Fëmijët kanë marrë terapi zhvillimi, logopedi dhe fizioterapi një herë në javë. Prindërit e tyre gjithashtu janë mbështetur duke punuar ngushtë punonjësia sociale me ta. Shërbimi Lëvizës ofron edhe ndihmë materiale dhe mbështetje psiko-sociale edhe për familjen e fëmijës me aftësi të kufizuar.

Gjatë këtyre dy viteve kanë marrë terapi zhvillimi, logopedi dhe fizioterapi një herë në javë 40 fëmijë me aftësi të kufizuar (29 djem dhe 11 vajza). Ndërkohë familjarët e fëmijëve kanë marrë shërbim social, ku përfshihet këshillim, menaxhim dhe monitorim të rasteve të familjeve që kanë probleme ekonomike dhe sociale, bashkëpunim dhe referim në institucione të tjera për marrjen e shërbimeve shtesë, hartime të Planeve të Zhvillimit të Familjeve dhe ndërrhyrje në ndërgjegjësim të komunitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

Secili specialist ka përgatitur plane dhe raportet për secilin fëmijë, ku përfshihen; vlerësimet e punonjësës sociale, vlerësimet e psikologes, vlerësimet biopsikosociale të përgatitura nga i gjithë ekipi, planet e zhvillimit individual, planet e zhvillimit të familjes, planet dy mujore për çdo fëmijë, kartela logopedike, fizioterapike etj. Në bazë të këtyre vlerësimeve dhe planeve, secili specialist e ka patur më të thjeshtë organizimin e punës dhe terapitë e shërbimet për secilin fëmijë/familjarë.

Gjatë këtyre dy viteve kemi bashkëpunuar me Drejtorinë Arsimore duke organizuar takime sensibilizuese e ndërgjegjësuese me mësues ndihmës, logoped, psikolog e punonjës social të shkollave të ndryshme duke ndarë planet e punës në mënyrë që fëmija të ndjekë të njëjtën linjë terapie.

Gjithashtu bashkëpunim shumë i ngushtë ka qënë edhe me çerdhet e kopshtet e Bashkisë Lezhë tek të cilët kemi referuar raste të fëmijë që kanë patur të domosdoshëm frekuentimin e kopshtit, por gjithashtu takime sensibilizuese me edukatorët duke diskutuar rreth bashkëpunimit me institucionet, me prindërit e fëmijëve kryesisht të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Bashkëpunimi ka qënë shumë i mirë dhe efikas.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe me partnerë të tjerë në zonë, specialistët e shërbimit lëvizës vazhdojnë të mbajnë takime me infermierët e zonës dhe mjekun e familjes, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës së fëmijëve dhe familjarëve të tyre.

Gjatë muajit qershor 2021 ekipi i projektit ka realizuar dy aktivitete argëtuese në bregdetin e Shëngjinit. Aktiviteti kishtë të përfshirë 10 prind dhe 10 fëmijë dhe kishtë si qëllim argetimine fëmijëve me lojra zhvilluese, por jo vetëm, e gjithashtu angazhimine prindërve në lojra grupi ku lejonte bashkëbisedimin e prindërve me njeri-tjetrin për të ndarë secili përvojat e tij.

Janë realizuar 10 vizita vlerësuese me pediatren e zhvillimit Dr. Donika Nace dhe 10 vizita me ortoped Dr. Erlis Iliazi.

Prindërit vazhdimisht kanë shprehur kënaqësi dhe optimizëm për këtë projekt që po implementohet për herë të parë. Ata shprehin nevojën e vazhdimësisë të këtij projekti pasi kanë parë rezultate të arrira tek fëmijët e tyre. Tashmë janë më të informuar në lidhje me marrjen e shërbimeve, të drejtave të tyre dhe detyrimeve që kanë institucionet shtetërore për fëmijët me aftësi të kufizuar.

**Menaxhëre Projekti**

**Jetmira Prenga**

Kono: J.Prenga

Kopje: nr.3 (tre)-copë

**Drejtor i Shërbimit dhe Kujdesit Social**

**Marte Fetaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1250 Prot.

Tiranë, më 11/03/2022

**Lënda:** Transferim Fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR  
TIRANË

BASHKISË DURRËS, GJIROKASTËR, LIBRAZHD, LEZHË, BERAT,  
RROGOZHINË, KUKËS, ELBASAN, KORÇË, VLORË, BELSH, PËRRENJAS,  
TIRANË

DEGËS SË THESARIT

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e Shtetit të vitit 2022", Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022" pika 105, gërma C si dhe kërkesës për transferim fondesh të Shërbimit Social Shtetëror nr. 555/13, datë 10.03.2022, bashkëlidhur gjeni transferimin e fondit social për 13 Bashkitë, projekt-propozimet e të cilave janë përzgjidhur nga MSHMS për tu mbështetur me financim".

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM  
  
GELARDINA PRODANI

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Transferim fondesh-Fondi Social për 13 bashki -ID 6584325

Tabela 1-Buxheti

Enti Qeverises	Gr 13	Kod I Institucionit	Emri I Institucionit	Kapitulli	Programi	Artikulli	Kodi I produktit	Kodi Degës Thesarit	Debiti Vjetor 2021	
				SHTESA						51,457,644
107	13	2107001	Durrës	01	10430	6060000	91307AH	0707	3,536,784	
115	13	2115001	Gjirokastrër	01	10430	6060000	91307AH	1111	1,987,018	
128	13	2128001	Librazhd	01	10430	6060000	91307AH	0821	2,503,632	
153	13	2153001	Prrerjas	01	10430	6060000	91307AB	0821	4,494,842	
127	13	2127001	Lezhë	01	10430	6060000	91307AH	2020	1,172,000	
102	13	2102001	Berat	01	10430	6060000	91307AH	0202	3,087,000	
119	13	2119001	Rrogozhinë	01	10430	6060000	91307AH	3513	4,384,032	
125	13	2125001	Kukës	01	10430	6060000	91307AH	1818	2,049,707	
109	13	2109001	Elbasan	01	10430	6060000	91307AH	0808	3,002,903	
122	13	2122001	Korçë	01	10430	6060000	91307AH	1515	7,909,118	
146	13	2146001	Vlorë	01	10430	6060000	91307AH	3737	8,018,188	
152	13	2152001	Belsh	01	10430	6060000	91307AH	0808	4,270,900	
101	13	2101001	Tiranë	01	10430	6060000	91307AH	3535	5,041,520	
				PAKSIME						51,457,644
001	13	1013141	SHSSH	01	10430	6060000	91307AH	3535	51,457,644	

## POLITIKA E PROGRAMIT

Programi Buxhetor Afatmesë 2021-2022

Programi 10430

## Përshkrimi i Programit

Ky program lidhet me :  
Ofrimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre.

1	<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe cilësisë së jetës për familjet dhe fëmijët me aftësi të kufizuar			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Ofrimi i terapive të fëmijëve me aftësi të kufizuar.	45	50		
	Aktivitetet ndërgjegjësuese në komunitet	20	40		
	Shërbime psiko-sociale me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar	60	100		
1.1.	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>				
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Rritja Nr. fëmijëve me aftësi të kufizuar	45	50		
1.2.	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>				
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Rritja Nr. të përfutësve në aktivitetet ndërgjegjësuese në komunitet	200	400		
1.3.	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>				
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Rritja e Nr. të prindërve në marrjen e shërbimeve sociale	60	100		

Kryetari i NJVV		Kordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri:	<i>[Signature]</i>	Emri Mbiemri:	<i>[Signature]</i>	Emri Mbiemri:	<i>[Signature]</i>
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Datë:	24.03.2022	Datë:	24.03.2022	Datë:	24.03.2022



**SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT**

**Programi Buxhetor Afatmesë 2021-2022**

**Programi 10430**

<b>1.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe cilësisë së jetës për fëmijet me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre			
<b>1.1.A.</b>	<b>Produkti</b>				
	<i>Kodi i Projektit</i>				
	Përshkrimi i Produktit:	Ofrimi i terapive të fëmijëve me aftësi të kufizuara			
	Njësia Matëse	numer			
		<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	45	50		
	Kosto totale (në mijë lekë)	1,644,292.0	3,263,320		
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	36,539.8	65,266.4		
	Ndryshimi në % i Sasisë		11.1%		
	Ndryshimi në % i kostos totale		98.5%		
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		78.6%		
<b>1.1.B.</b>	<b>Produkti</b>				
	<i>Kodi i Projektit</i>				
	Përshkrimi i Produktit:	Aktivitete ndërgjegjësuese në komunitet			
	Njësia Matëse	numer			
		<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	200	400		
	Kosto totale (në mijë lekë)	1,644,292.0	3,263,920		
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	8,221.5	8,159.8		
	Ndryshimi në % i Sasisë		100.0%		
	Ndryshimi në % i kostos totale		98.5%		
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		-0.7%		
<b>1.1.C.</b>	<b>Produkti</b>				
	<i>Kodi i Projektit</i>				
	Përshkrimi i Produktit:	Shërbime psiko-sociale me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara			
	Njësia Matëse	numer			
		<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	60	100		
	Kosto totale (në mijë lekë)	1,644,292.0	3,263,920		



Kosto për njësi (në mijë lekë)	27,404.9	32,639.2		
Ndryshimi në % i Sasisë		66.7%		
Ndryshimi në % i kostos totale		98.5%		
Ndryshimi në % i kostos për njësi		19.1%		

Kryetari i NJVV		Kordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri:	<i>P. Eni</i>	Emri Mbiemri:	<i>Evedis Hoxha</i>	Emri Mbiemri:	<i>Mozeta Paj</i>
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Datë:	<i>24.03.2022</i>	Datë:	<i>24.03.2022</i>	Datë:	<i>24.03.2022</i>




Sëmundje dhe paaftësi, Projekti "Shërbimi lëvizës "Tungjatjeta Jete" për fëmijët me aftësi të kufizuara

PROGRAMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE				SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK				SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT					
Qëllimi i Programit	Objektivi	Situata aktuale	Situata e synuar	Përshkrimi aktiviteteve	Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kostoja vjetore 000/lek	Te ardhurat vendore	Transferta e pakushtëzuara dhe shërbimet sociale	Ministria e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Transferta e kushtëzuara
Ofrimi i shërbimit lëvizës të specializuar për 50 (32M/18F) fëmijë me aftësi të kufizuara që përmban "Shërbimit Lëvizës Komunitar aksesojnë dot qendrat e ofrimit të shërbimeve	Të ofrohen shërbime të specializuara në banesë për fëmijët me aftësi të kufizuara përmban "Shërbimit Lëvizës Komunitar	Vetëm 30 (5F/25M) nga 291 (184M/107F) fëmijë me aftësi të kufizuara, të identifikuar e vlerësuar nga KMCAP, marrin shërbime nga qendrat që veprojnë në territorin e bashkisë Lezhë.	50 fëmijë me AK (32M/18F) vazhdojnë terapitë në bazë të vështirësive që kanë duke përmirësuar cilësinë e jetesës së tyre nëpërmjet shërbimeve direkte nga 4 profesionistët e trajnuar (ekipi i shërbimit lëvizës në banesë).	Paga dhe siguri me 5 punonjës	2,096,400	350,100			2,446,500	1,274,500	1,172,000		
<b>Totali viti 2022</b>					<b>2,096,400</b>	<b>350,100</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,446,500</b>	<b>1,274,500</b>	<b>1,172,000</b>	<b>0</b>	

Përgjegjës i sektorit: **Jetmira Prenga**

Drejtuuesi i EMP : **Marte Fetaj**




PËRSHKRIMI I TREGUESVE TË MONITORIMIT TË PËRFORMANCËS

Nr.	Emërtimi i treguesve	Sipas viteve	
		2020	2021
1	Tregues në nivel kombëtar	-	-
2	Tregues në nivel vendor	-	-
a	Përfitues nga mbulimi i shërbimit lëvizës	40	45
b	Përfitues femra nga shërbimi lëvizës	11	13
c	Përfitues meshkuj nga shërbimi lëvizës	29	32

Përgjegjës i Sektorit: **Jetmira Prenga**

Drejtuksi i EMP: **Marte Fetaj**




Nr.	Emri i Projektit : <b>Sëmundje dhe paaftësi</b> Projekti Shërbimi lëvizës "Tungjatjeta Jete" për fëmijët me aftësi të kufizuar	Funksioni : 10140 Programi : Kodi i Programit:
<p><b>a) Qëllimi i projektit</b></p> <p>Vazhdimi i zbatimit të modelit pilot i ofrimit të shërbimeve në familje: Ofrimi i shërbimit lëvizës të specializuar për 50 (32M/18F) fëmijë me aftësi të kufizuar që nuk aksesojnë dot qendrat e ofrimit të shërbimeve , bazuar sipas Planit Social në:</p> <p>Objektivin strategjik 3 – Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuar</p> <p><i>dhe</i></p> <p>Objektivin specifik 5.5 – Zhvillimi i shërbimeve parashoqërore (Konceptimi dhe zbatimi i modelit pilot të ofrimit të shërbimeve në familje si dhe zgjerimi i hartës së shërbimeve përmes angazhimit të skuadrave të terrenit)</p>		
<p><b>b) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b></p> <p>Modeli i ndërhyrjes "Shërbimi Lëvizës" është një bashkëveprim i shërbimeve në shtëpi dhe mobilizimit të komunitetit. Shërbimi lëvizës i referohet ekipit të profesionistëve të cilët ofrojnë asistencën e tyre në terren, të cilët janë trajnuar për të identifikuar, referuar, adresuar problematika në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, ofruar shërbime të specializuara për fëmijët me Aftësi të Kufizuar,që veprojnë në një zonë me shërbime të limituara ose plotësisht të munguara.</p> <p>Shërbimet në shtëpi nënkuptojnë që një njësi lëvizëse e cila ka në përbërjen e saj një ekip profesionistësh; një menaxher projekti/ një punonjës social, një fizioterapist, një logopedist dhe një shofer, që përbëjnë një strukturë me aftësi dhe infrastrukturë të nevojshme (automjet, materiale ndihmëse),ofron mbështetje dhe shërbim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuar në vendin ku ata jetojnë (shtëpi).</p>		
<p><b>i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</b></p> <p>Ofrimi i shërbimeve rehabilituese dhe integruese janë nje sfidë për Bashkinë Lezhë, sidomos pas reformës administrative territoriale të vitit 2015. Komuniteti i personave me aftësi të kufizuar në Lezhë, vazhdon të hasë vështirësi të cilat i pengojnë ata të jenë qytetarë me të drejta dhe mundësi të barabarta me të gjithë pjesën tjetër të shoqërisë. Vetëm 30 (5F/25M) nga 291 (184M/107F) fëmijë me aftësi të kufizuar, të identifikuar e vlerësuar nga KMCAP, marrin shërbime nga qendrat që veprojnë në territorin e bashkisë. Mungesa e shërbimeve komunitare në zonat rurale është një nga faktorët që pengon integrimin dhe rehabilitimin në komunitet të fëmijëve me aftësi të kufizuar në Bashkinë Lezhë, duke penguar kështu respektimin e një të drejte themelore të tyre.</p>		
<p><b>ii. Objektivat e projektit</b></p>		

Me anë të këtij projekti kemi për qëllim zbatimin e modelit pilot në Bashkinë Lezhë të ofrimit të shërbimeve në familje për 50 fëmijë (vajza dhe djem) me aftësi të Kufizuar që nuk aksesojnë dot qendrat e ofrimit të shërbimeve.

Objektivat e projektit janë :

1. Të ofrohen shërbime të specializuara ne banese për fëmijët me aftësi të kufizuar përmes “Shërbimit Lëvizës Komunitar”;
2. Të vazhdohet me koordinimin multidisiplinar dhe ndërsektorial, si dhe ngritja e kapaciteteve të agjencive publike dhe jopublike në dhënien e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe të familjeve të tyre; si psh, mësues mbështetës të shkollave, infermier të zonave.
3. Të rritet përfshirja aktive e familjarëve dhe komunitetit në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

### iii. Aktivitete e projektit:

-Vazhdimi i terapeive për 50 familje dhe fëmijë me AK (32M/18F) do të marrin shërbime direkte, duke përmirësuar cilësinë e jetesës së tyre ofrohen shërbime direkte nga 4 profesionistë të trajnuar (ekipi i shërbimit lëvizës) dhe të pajisur me aftësi dhe infrastrukturen e duhur (automjeti lëvizës).

-Takime bashkëpunuese me mësues mbështetës dhe infermier të zonave.

-Realizimi i 5 aktiviteteve argëtuese dhe zhvilluese për fëmijët me AK që janë të përfshirë në projekt.

-Rivlerësimi i rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ekipi i njësisë lëvizëse

-Ofrimi nga njësia lëvizëse i mbështetjes cilësore me shërbim social, terapi zhvillimi, logopedi dhe fizioterapi për fëmijët me aftësi të kufizuara

- Informimi dhe mbështetja e anëtarëve të familjes/kujdestarët me informacion lidhur me të drejtat dhe aktivitetet që mund të bëjnë në shtëpi për të përmirësuar rezultatet e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

-Ngritja e tryezave të rumbullakëta dhe konferenca/ shkëmbime përvoja me specialistët e gjithëpërfshirjes si Punonjësit Social të 10 njësive administrative dhe specialistë të tjerë të fushës në kuadër të transparencës dhe vizibilitetit të shërbimit përfshirë analiza progresi dhe rekomandime për përmirësimin e shërbimit në kuadër të planit social.

-Vizibiliteti me anë të broshurave dhe aktiviteteve në ditët ndërkombëtare të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe aftësisë së kufizuar.

### c) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet e gatshme që u dorezoni perfutuesve te synuar)

-50 fëmijë me AK (32M/18F) vazhdojnë terapatitë në bazë të vështrësive që kanë duke përmirësuar cilësinë e jetesës së tyre nëpërmjet shërbimeve direkte nga 4 profesionistët e trajnuar (ekipi i shërbimit lëvizës në banesë) dhe të pajisur infrastrukturen e duhur.

-Dy takime koordinimi me grupin multidisiplinar të specialistëve dhe të agjencive publike dhe jopublike që kanë fokus personat me AK, për ecurinë e projektit dhe ndarjes së roleve, duke përfshirë mësues mbështetës dhe infermier të zonave.

- Personel i trajnuar i shërbimeve sociale për të aplikuar në mënyrën e duhur shërbimin e përshtatshëm për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve bazë.

- Dhjetë (10) takime ndërgjegjësuese me prindërit/ kujdestarët e fëmijëve me AK.

- Dhjetë (10) takime ndërgjegjësuere me anëtarë me nga 30 pjesëmarrës të komunitetit për respektimin e të drejtave të fëmijëve me AK si dhe njohjen e tyre me projektin.

- Realizimi i 5 aktiviteteve argëtuese dhe zhvilluese për fëmijët me AK që janë të përfshirë në projekt.

<p><b>d) Grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen/perfitojne direct nga projekt</b> Fëmijë me aftësi të kufizuar 0-18 vjeç në të gjithë Njësitë Administrative të Bashkisë Lezhë Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar</p>	<p><b>e) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b> Bashkia Lezhë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale World Vision</p>
--	--

**f) Treguesit e performances**  
50 fëmijë me aftësi të kufizuar 0-18 vjeç (32 djem dhe 18 vajza)  
Të gjithë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar ndërgjegjësohen dhe aftësohen për tju bërë vetë terapi fëmijëve të tyre

**g) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërme 2.446.500 lekë) Viti 2022**

	Paga	Sigurime	Transferta	Kapitale/ Investime	Totali	Burimi i financimit		
						Të ardhurat	Transferte e pakushtëzuar	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Tjera
1. Paga dhe sigurime shoqërore (menaxher projekti, punonjës social, fizioterapistë, logopedistë, shofer)	2,096,400	350,100			2,446,500	1,274,500	1.172.000	
2. Blerje e automjeteve								
3. Karburant								
4. Qera zyra								
5. Salla, ambiente për aktivitete								
<b>Shuma</b>	<b>2,096,400</b>	<b>350,100</b>			<b>2,446,500</b>	<b>1,274,500</b>	<b>1.172.000</b>	

Përgjegjësi i sektorit : **Jetmira Prenga**    
Drejtuessi i E.M. Programit: **Marte Fetaj**